



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 215/2 prot

Datë 31.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-87736-11-15-2023, me objekt “*Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore , masterplane , projet-ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara*”, me fond limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

**Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK me NIPT (L72023002P) & “DAAM” SHPK me NIPT (L72205042F), me adresë: Rruga “Haxhi Dalliu”, Hyrja 1, Apartamenti 0, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër

Në datën 30.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 215 protokolli, datë 30.01.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-87736-11-15-2023, me objekt “*Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projet-ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara*”, me fond limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 215 protokoli, datë 30.01.2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

1. - *Oferta juaj skualifikohet bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020”Për prokurimin publik”,pika 2 dhe pika 3,Vendimit nr.113, date 1.3.2023 “”Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pasi drejtuesit teknik te shoqerise Net Group sh.p.k., D.Mitrushi , L.Kuci , B.Demneri , E.Spahiu dhe L. Falaska referuar listepageses se muajit te fundit nuk jane paguar me ditete plota pune ne kundershtrim te plote me kontratat individuale te punes ku figurojne me kohe te plote dhe te deklarates ne formularin permbledhes te vetdeklarimit piken D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.*

- *Oferta juaj skualifikohet bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020”Për prokurimin publik”,pika 2 dhe pika 3,Vendimit nr.113, date 1.3.2023 “”Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pasi drejtuesit teknik te shoqerise DAAM sh.p.k., A.Bani dhe F.Dalipi , referuar listepageses se muajit te fundit nuk jane paguar me dite te plota pune ne kundershtrim te plote me kontratat individuale te punes ku figurojne me kohe te plote dhe te deklarates ne formularin permbledhes te vetdeklarimit piken D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 31.01.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**